Anketa e Buxhetit të Hapur 2025

Kosova



INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE

International Budget Partnership

Anketa e Buxhetit të Hapur 2025
Kosova

Nëntor 2026

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive ---- 01
1. Hyrje ---- 02
2. Metodologjia ---- 03
3. Krahasim me OBS 2023 ---- 03
4. Rezultatet sipas komponentëve kryesorë ---- 04
4.1 Transparenca e buxhetit ---- 04
4.2 Pjesëmarrja publike ---- 06
4.3 Mbikëqyrja e buxhetit ---- 07
5. Përfundim dhe rekomandime ---- 10
Aneks 1 – Metodologjia ---- 12

Deklaratë mohimi:

Ky projekt zbatohet me mbështetjen e Komisionit Evropian. Përmbajtja është përgjegjësi e vetme e Institutit GAP dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Komisionit Evropian.

Përmbledhje ekzekutive

Transparenca, pjesëmarrja e qytetarëve dhe mbikëqyrja institucionale janë parime thelbësore për menaxhimin e mirë të financave publike dhe llogaridhënien. Anketa e Buxhetit të Hapur (Open Budget Survey – OBS), e zhvilluar nga Partneriteti Ndërkombëtar i Buxhetit (IBP), vlerëson praktikat e qeverive në këto tri fusha: transparencë, pjesëmarrje publike dhe mbikëqyrje të buxhetit. Në vitin 2025, anketa përfshiu 82 vende dhe analizoi dokumentet dhe aktivitetet buxhetore të publikuara gjatë vitit 2024.

Rezultatet e anketës[1] për Kosovën tregojnë se vendi ka arritur 57 pikë nga 100 në transparencën buxhetore, 32 pikë në pjesëmarrjen publike dhe 61 pikë në mbikëqyrjen e buxhetit. Megjithëse krahasuar me vitin 2023 vërehet rritje në të tri fushat, një pjesë e këtij progresi lidhet me ndryshimet në metodologjinë dhe kriteret e vlerësimit, prandaj nuk reflekton domosdoshmërisht përmirësim të drejtpërdrejtë të praktikave institucionale. Në transparencën buxhetore, gjashtë nga tetë dokumentet e vlerësuara janë publikuar me kohë, ndërsa Broshura Informative për Qytetarët është publikuar me vonesë dhe Rishikimi i Mes-vitit nuk është përgatitur. Në aspekt të përmbajtjes, përmbajtjen më gjithëpërfshirëse e kanë Raporti i Auditimit (95 pikë), Deklarata e Para-Buxhetit dhe Buxheti i Miratuar (nga 89 pikë). Në anën tjetër, Propozimi i Buxhetit dhe Raporti Vjetor Financiar kanë nevojë për informata dhe analiza më të detajuara. Në krahasim me vendet e rajonit dhe Turqinë, Kosova renditet e treta në transparencë buxhetore.

Në pjesëmarrjen publike, Kosova renditet e para në rajon, por rezultati prej 32 pikësh tregon se përfshirja e qytetarëve mbetet e kufizuar. Vlerësimi më i lartë është shënuar në fazën e formulimit të buxhetit (73 pikë), kryesisht si rezultat i dëgjimeve buxhetore në nivel komunal. Ndërkaq, fazat e miratimit dhe ekzekutimit të buxhetit kanë marrë zero pikë, ndërsa auditimi 33 pikë. Kjo dëshmon mungesën e mekanizmave formalë për përfshirjen e qytetarëve përgjatë të gjitha fazave të procesit buxhetor. Në mbikëqyrjen e buxhetit, Kosova ka arritur 61 pikë, duke përmbushur pragun e performancës së mjaftueshme. Këto pikë vijnë nga dy institucionet kryesore të mbikëqyrjes së buxhetit: Kuvendi, me 50 pikë, që tregon një mbikëqyrje ende të kufizuar, ndërsa Zyra Kombëtare e Auditimit arriti 84 pikë, gjë që e bën vlerësimin e përgjithshëm më të lartë. Gjithashtu, anketa evidenton mungesën e një institucioni të pavarur fiskal, i cili do të kontribuonte në analiza të pavarura dhe në forcimin e mbikëqyrjes së politikave fiskale.

Bazuar në këto rezultate, Instituti GAP rekomandon që Ministria e Financave të përmirësojë përmbajtjen dhe publikimin me kohë të dokumenteve buxhetore, përfshirë publikimin e rregullt të Rishikimit të Mes-vitit, si dhe të krijojë mekanizma konsultimi publik në nivel qendror. Kuvendi duhet të fuqizojë mbikëqyrjen parlamentare dhe të mundësojë pjesëmarrjen e qytetarëve në shqyrtimin e buxhetit, ndërsa Zyra Kombëtare e Auditimit duhet të zgjerojë përfshirjen e qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile në proceset e auditimit. Në periudhë më afatgjatë, rekomandohet krijimi i një institucioni të pavarur fiskal për të forcuar transparencën dhe llogaridhënien në menaxhimin e financave publike.

[1] International Budget Partnership. Anketa e Buxhetit të Hapur 2025 – pyetësori.

1. Hyrje

Transparenca në menaxhimin e financave publike dhe përfshirja e qytetarëve në procesin buxhetor janë faktorë të rëndësishëm për qeverisje të mirë, llogaridhënie dhe menaxhim të financave publike. Qytetarët duhet të kenë qasje në informata të sakta dhe me kohë për mënyrën se si planifikohen dhe shpenzohen fondet publike, si dhe mundësi për të dhënë kontributin e tyre në vendimet që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e tyre.

Anketa e Buxhetit të Hapur (Open Budget Survey - OBS)[2] është një vlerësim i pavarur global që realizohet nga hulumtues të pavarur lokalë nëpër shtete, si organizata të shoqërisë civile (OSHC) apo institucione akademike, dhe analizon praktikat e qeverive në menaxhimin e financave publike. Anketa vlerëson tri fusha kryesore: transparencën buxhetore, përmes disponueshmërisë dhe përmbajtjes së dokumenteve buxhetore, pjesëmarrjen e publikut, përmes mundësive që u ofrohen qytetarëve për t'u përfshirë në procesin buxhetor, si dhe mbikëqyrjen, përmes rolit të parlamenteve dhe institucioneve të auditimit. Në vitin 2025, OBS vlerësoi gjithsej 82 vende dhe shqyrtoi dokumentet dhe praktikat buxhetore të publikuara gjatë vitit 2024. Gjetjet e raportit global për vitin 2025 tregojnë se, ndonëse transparenca dhe mbikëqyrja kanë arritur nivele të moderuara, pjesëmarrja e publikut mbetet e ulët. Një sfidë që veçohet është mungesa e informatave të mjaftueshme gjatë zbatimit të buxhetit. Krahasuar me dokumentet që lidhen me planifikimin buxhetor, raportet mbi realizimin e buxhetit, rishikimet e mesvitit dhe raportet e fundvitit publikohen më rrallë dhe shpesh përmbajnë më pak informata. Kjo e vështirëson mbikëqyrjen pikërisht në periudhën kur është e rëndësishme të kuptohet se si po realizohen planet dhe si po ndryshojnë prioritetet e shpenzimeve publike.

Për Kosovën, Anketa e Buxhetit të Hapur 2025 paraqet një vlerësim të rëndësishëm të praktikave të transparencës, pjesëmarrjes dhe mbikëqyrjes buxhetore. Pas vlerësimit të parë pilot të realizuar nga Instituti GAP në vitin 2023[3], ky edicion shënon pjesëmarrjen e Kosovës në një vlerësim të plotë të OBS. Gjetjet evidentojnë praktikat ekzistuese, por edhe fushat ku nevojiten përmirësime, veçanërisht në publikimin me kohë të dokumenteve buxhetore, zgjerimin e mundësive për konsultim publik dhe forcimin e mbikëqyrjes institucionale.

Ky raport paraqet dhe analizon gjetjet e Anketës së Buxhetit të Hapur 2025 për Kosovën, duke shqyrtuar veçmas tri fushat kryesore të vlerësimit. Gjithashtu, ai identifikon sfidat dhe ofron rekomandime për Ministrinë e Financave, Kuvendin e Kosovës dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, me synim avancimin e transparencës, përfshirjen e qytetarëve dhe rritjen e llogaridhënies në menaxhimin e financave publike.

[2] International Budget Partnership. Open Budget Survey. Maj 2026. Qasja e fundit më 12 nëntor 2026.

[3] Instituti GAP. Anketa e Buxhetit të Hapur 2023 – Kosova. Dhjetor 2024. Qasja e fundit më 12 nëntor 2026.

2. Metodologjia

Anketa e Buxhetit të Hapur (OBS) 2025 është një pyetësor me gjithsej 218 pyetje, i ndarë në tre komponentë kryesorë si: transparenca, pjesëmarrja e publikut dhe mbikëqyrja. Nga këto pyetje, 145 prej tyre vlerësohen me pikë ndërsa 73 prej tyre nuk vlerësohen me pikë mirëpo përdoren për të mbledhur informata shtesë që e plotësojnë vlerësimin përfundimtar. OBS 2025 vlerëson të gjitha dokumentet e publikuara dhe aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2024, deri më 31 dhjetor 2024. Nga 145 pyetjet e vlerësuara, gjithsej 109 nga to vlerësojnë disponueshmërinë e të dhënave buxhetore, 18 nga to vlerësojnë mundësitë e qytetarëve për pjesëmarrje në procese buxhetore, dhe 18 nga to vlerësojnë rolin e Kuvendit dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit në mbikëqyrje të këtyre proceseve.[4] Më konkretisht, komponenti i transparencës vlerëson sa janë të disponueshme dhe gjithëpërfshirëse tetë[5] dokumentet kyçe buxhetore duke analizuar rrjedhimisht planifikimin dhe shpenzimin e buxhetit publik. Për t'u vlerësuar që janë të disponueshme, dokumentet duhet të jenë të publikuara online me kohë dhe duhet të përfshijnë informata relevante. Komponenti i pjesëmarrjes publike vlerëson se sa kanë mundësi qytetarët të marrin pjesë në të gjitha fazat e procesit buxhetor duke filluar nga hartimi, aprovimi, realizimi dhe auditimi. Ndërsa, komponenti i mbikëqyrjes vlerëson se sa janë të përfshira Kuvendi (përfshirë komisionet parlamentare) dhe Zyra Kombëtare e Auditimit në mbikëqyrje të procesit buxhetor. Vlerësimet mund të jenë nga 0 në 100 pikë; një vlerësim prej 0-40 pikë tregon që ka performancë të ulët, prej 41-60 pikë tregon që ka performancë të kufizuar, dhe mbi 61 pikë konsiderohet performancë adekuate apo e mjaftueshme. Më shumë detaje rreth metodologjisë janë të paraqitura në Aneks 1.

3. Krahasim me Anketën e Buxhetit të Hapur (OBS) 2023

Anketa e Buxhetit të Hapur (OBS) 2023 përfaqësoi vlerësimin e parë pilot për Kosovën, duke u realizuar për herë të parë në vend. Ndërkaq, OBS 2025 shënoi kalimin nga faza pilot në zbatimin e plotë të vlerësimit, duke e përfshirë Kosovën për herë të parë në listën e vendeve pjesëmarrëse në një edicion jo-pilot të OBS. Nëse krahasohen rezultatet në të dy vitet, vërehen dallime në vlerësim, e më së shumti tek komponenti i pjesëmarrjes publike. Në përgjithësi, në të tre komponentët rezultatet janë më të larta në vitin 2025; megjithatë, ky vlerësim është kryesisht si rezultat i disa ndryshimeve në metodologji dhe kritere të vlerësimit, dhe pak nga performanca më e mirë. Dallimi më i madh është tek pjesëmarrja publike, ku në vlerësimin e vitit 2025 është përfshirë edhe procesi buxhetor në nivel lokal. Më konkretisht, në vlerësim janë përfshirë edhe dëgjimet buxhetore me qytetarë nëpër komuna, për të cilat janë publikuar edhe raporte pas realizimit, ku janë dokumentuar propozimet e qytetarëve dhe nëse ato janë pranuar apo jo. Rrjedhimisht, përfshirja e nivelit lokal gjatë procesit të planifikimit buxhetor, ka ndikuar në një vlerësim më të lartë të Kosovës në këtë komponentë në vitin 2025. Për dallim, në vlerësimin pilot të vitit 2023, nuk është përfshire procesi buxhetor në nivel lokal.

Tek komponenti i mbikëqyrjes, në vitin 2025 kishte një përmirësim të lehtë në vlerësim. Ky përmirësim erdhi kryesisht si rezultat i miratimit më të hershëm të buxhetit (një muaj para fillimit të vitit fiskal) nga Kuvendi dhe përfshirjes më të madhe të komisioneve parlamentare në shqyrtimin e projektbuxhetit. Për më shumë, në këtë vit është evidentuar edhe një vlerësim i pavarur i proceseve të auditimit që është realizuar për Zyrën Kombëtare të Auditimit, duke kontribuar në rritje të llogaridhënies dhe forcim të mbikëqyrjes institucionale.

[4] International Budget Partnership. Lidhur me Anketën e Buxhetit të Hapur. Qasur së fundmi më: 12 nëntor 2026

[5] Dokumentet e vlerësuara në OBS janë: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2025-2027, Projektligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, Broshura informative për qytetarët 2024, Raporti Financiar tremujor, gjashtëmujor, nëntëmujor gjatë vitit 2024, Rishikimi i mes-vitit, Raporti Financiar Vjetor i Buxhetit të Republikës së Kosovës 2023, dhe Raporti i Auditimit për Buxhetin e Republikës së Kosovës 2023.

Edhe në transparencë, në vitin 2025 kishte një përmirësim të lehtë në vlerësim. Ky vlerësim erdhi kryesisht si rezultat i disa ndryshimeve në metodologji, të cilat mundësuan përfshirjen e disa dokumenteve shtesë si burime në pyetje të caktuara. Për më shumë, një ndryshim tjetër në metodologji ishte edhe ndryshimi në disa kritere të vlerësimit, e që rezultoi në performancë më të mirë. Një përmirësim në publikim të dokumenteve ishte për Raportin Vjetor Financiar 2023, i cili u publikua brenda një periudhe gjashtë mujore pas përfundimit të vitit.

4. Rezultatet sipas komponentëve kryesorë

Sipas rezultateve të anketës për vitin 2025, Kosova ka arritur rezultat prej 57 (nga 100) pikëve për transparencë buxhetore. Ky komponent i anketës bën matjen e qasshmërisë publike, publikimit me kohë dhe përmbajtjes gjithëpërfshirëse të tetë dokumenteve kyçe buxhetore të përmendura më lartë. Ky vlerësim bazohet në gjithsej 109 indikatorë të peshuar në mënyrë të barabartë. Lidhur me komponentin e pjesëmarrjes publike, rezultatet tregojnë që Kosova ka arritur gjithsej 32 (nga 100) pikë. Këtu vlerësohen mekanizmat formal të Qeverisë, Kuvendit dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit në përfshirjen e qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile në fazat e ndryshme të procesit buxhetor.[6] Në mbikëqyrje, ku vlerësohet roli i Kuvendit dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit në mbikëqyrjen e procesit buxhetor, Kosova ka arritur gjithsej 61 (nga 100) pikë. Sipas vlerësimit me pikë, janë tre nivele të performancës: e dobët (0-40), e kufizuar (41-60) dhe adekuate (61-100).[7]

Figura 1. Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Hapur 2025 për Kosovën



4.1 Transparenca e buxhetit

Në transparencën e buxhetit, ku vlerësohet disponueshmëria dhe përmbajtja e dokumenteve buxhetore, Kosova është vlerësuar me 57 pikë (nga 100), që konsiderohet performancë e kufizuar. Sa i përket disponueshmërisë dhe publikimit me kohë të dokumenteve buxhetore, rezultatet tregojnë se gjashtë nga gjithsej tetë dokumentet e vlerësuara janë të qasshme për publikun dhe janë publikuar me kohë. Megjithatë, Broshura Informative për Qytetarët 2024 (apo sipas terminologjisë së OBS: Buxheti i qytetarëve), është publikuar me vonesë, ndërsa Rishikimi i Mes-vitit 2024 nuk është përgatitur. Këto dy dokumente, e në veçanti Buxheti i qytetarëve, është shumë e rëndësishme të publikohen në kohë, meqë u mundësojnë qytetarëve të informohen me kohë rreth planifikimit dhe zbatimit të buxhetit.

Nëse analizojmë përmbajtjen e dokumenteve buxhetore vërehen dallime të konsiderueshme në përmbajtjen e tyre. Rezultatin më të lartë e ka **Raporti i Auditimit** për vitin 2023, me 95 pikë, që tregon se ky dokument ka një përmbajtje mjaft gjithëpërfshirëse dhe përmban një nivel të lartë të informatave. Po ashtu, **Deklarata e Para-Buxhetit** dhe **Buxheti i Miratuar** kanë shënuar nga 89 pikë secili. Këto rezultate dëshmojnë se dokumentet përkatëse përmbushin në masë të madhe kërkesat për transparencë dhe ofrojnë informata të rëndësishme mbi politikat fiskale, parashikimet ekonomike dhe ndarjet buxhetore. Tek Deklarata e Para-Buxhetit (apo KASH), disa përmirësime mund të bëhen tek borxhi publik dhe kostot e shërbimit të borxhit, ku mund të ofrohet një analizë më e qartë afatmesme. Për më shumë, duhet të dallohen më qartë të hyrat që priten nga politikat ekzistuese dhe nga masat e reja tatimore ose jotatimore. Tek Buxheti i Miratuar, rekomandohet të shtohet një tabelë që tregon dallimet kryesore (nëse ka) në mes të

[6] International Budget Partnership. Rezultatet sipas shteteve. Qasur së fundmi më: 15 nëntor 2026

[7] International Budget Partnership. Lidhur me Anketën e Buxhetit të Hapur. Qasur së fundmi më: 12 nëntor 2026

Figura 2. Disponueshmëria publike (transparenca) dhe përmbajtja gjithëpërfshirëse e dokumenteve buxhetore në Kosovë

Dokumenti buxhetor	Viti fiskal i vlerësuar	Vlerësimi i transparencës	Vlerësimi i përmbajtjes gjithëpërfshirëse
Deklarata e Para-Buxhetit *Korniza Afatmesme e Shpenzimeve*	2025-2027		89
Propozimi i Buxhetit nga Qeveria *Projekt-buxheti*	2025		56
Buxheti i Miratuar	2025		89
Buxheti i Qytetarëve *Broshura Informative për qytetarët*	2024		0
Raportet gjatë vitit *Raportet financiare tremujore, gjashtëmujore dhe nëntëmujore*	2024		78
Rishikimi i mes-vitit	2024		0
Raporti i fundvitit *Raporti vjetor financiar*	2023		59
Raporti i Auditimit	2023		95

Publikuar online **Publikuar vonë ose për përdorim të brendshëm** **Nuk është publikuar**

Burimi: Anketa e Buxhetit të Hapur (OBS), 2025.

Propozimit të Buxhetit nga Qeveria dhe buxhetit të miratuar nga Kuvendi.

Raportet gjatë vitit (Raporti financiar tremujor, gjashtëmujor dhe nëntëmujor) kanë arritur rezultatin prej 78 pikësh, që nënkupton një nivel relativisht të mirë të raportimit mbi të hyrat dhe shpenzimet e realizuara, dhe borxhin publik gjatë zbatimit të buxhetit. Megjithatë, shpenzimet nuk paraqiten sipas programeve, ku rekomandohet të shtohen informatat në nivel programi dhe të paraqitet ndarja fillestare, shpenzimi i realizuar dhe shuma e mbetur. Për më shumë, devijimet në shuma të konsiderueshme nga linjat buxhetore, e në veçanti investimet kapitale, duhet të kenë sqarime. Në anën tjetër, **Raporti i Fundvitit** është vlerësuar me 59 pikë, që tregon se ky dokument ka hapësirë për përmirësim në aspektin e gjithëpërfshirjes së informacioneve. Sipas rezultateve të OBS, rekomandohet që ky raport të përmbajë më shumë informata mbi realizimin e politikave dhe performancën e tyre. Në veçanti, rekomandohet që të paraqiten më qartë linjat e dedikuara për politikat që ndikojnë tek grupet më të varfra dhe të cenueshme të shoqërisë, si dhe të bëhet krahasimi ndërmjet rezultateve të planifikuara dhe atyre të realizuara. Gjithashtu, rekomandohet përfshirja e të dhënave më të detajuara për borxhin dhe parashikimet makroekonomike.

Propozimi i Buxhetit nga Qeveria (Projekt-buxheti) ka marrë një vlerësim të kufizuar prej 56 pikëve, dhe është dokumenti kryesor buxhetor edhe sipas metodologjisë së OBS, me numrin më të madh të pyetjeve. Lidhur me këtë dokument, rekomandohet që të përfshihet ndarja e shpenzimeve sipas klasifikimit funksional dhe grupimi i tyre të bëhet sipas atij klasifikimi. Për më tepër, propozimi i buxhetit nuk përfshin një "analizë të ndjeshmërisë", e cila tregon efektin e mundshëm të ndryshimeve makroekonomike në buxhet. Kjo mund të analizojë, për shembull, efektin e nivelit më të ulët të të ardhurave të arkëtuara ose të inflacionit më të lartë në buxhet. Tutje, duhet të paraqitet qartë ndikimi fiskal i politikave të reja, duke shfaqur politikën e propozuar, institucionin përgjegjës, dhe ndikimin buxhetor. Për më shumë, sipas gjetjeve të anketës, rekomandohet që deklarata e rreziqeve fiskale të zgjerohet dhe të mbulojë edhe garancitë, ndërmarrjet publike, dhe aktivitetet kuazi-fiskale. Gjithashtu, rekomandohet të shtohet një pasqyrë e shpenzimeve tatimore, ku paraqiten përjashtimet tatimore, normat e reduktuara, përfituesit dhe vlerësimi i të hyrave të humbura.

Në krahasim me vendet e rajonit dhe Turqinë, Kosova renditet në vendin e tretë në transparencë me gjithsej 57 pikë, pas Turqisë me 65 pikë dhe Shqipërisë me 64 pikë. Pas Kosovës renditet Mali i Zi me 54 pikë, Serbia me 53 pikë, Maqedonia e Veriut me 39 pikë dhe Bosnja dhe Hercegovina me 30 pikë. Këto rezultate tregojnë se Kosova ka një

performancë relativisht më të mirë në transparencën buxhetore krahasuar me shumicën e vendeve të rajonit, megjithëse ende nuk e arrin pragun prej 61 pikësh që konsiderohet i mjaftueshëm sipas metodologjisë së OBS.

Figura 3. Rezultatet e transparencës buxhetore në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi, 2025



Burimi: Anketa e Buxhetit të Hapur (OBS), 2025.

Nëse krahasohen rezultatet e këtij viti me vlerësimin e vitit 2023, mund të vërejmë që në rajon nëse nuk përfshihet Turqia, Kosova është ngritur për një vend më lartë, në vend të dytë pas Shqipërisë. Në anën tjetër, Shqipëria vazhdon të jetë në vend të parë, me një vlerësim edhe më të lartë prej 64 pikësh. Edhe vendet tjera si Serbia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Bosnja dhe Hercegovina kanë vlerësim më të lartë këtë vit, mirëpo mbeten në rangim më poshtë se Kosova.

4.2 Pjesëmarrja publike

Sipas rezultateve të OBS 2025, Kosova ka shënuar 32 pikë nga 100 në pjesëmarrjen e publikut. Ky rezultat paraqet një nivel ende të kufizuar të përfshirjes së qytetarëve në procesin buxhetor, ndonëse Kosova renditet më mirë se vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor dhe Turqia. Në këtë komponent maten mundësitë dhe mekanizmat formal që institucionet publike u ofrojnë qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile për të marrë pjesë në fazat e ndryshme të procesit të buxhetit. Ky vlerësim bëhet në disa faza të procesit buxhetor: formulim (Qeveria), miratim (Kuvendi), zbatim (Qeveria) dhe auditim (Zyra Kombëtare e Auditimit). Pra përfshihen mekanizmat e krijuar nga të gjitha nivelet duke filluar nga niveli lokal, Qeveria, Kuvendi dhe Zyra Kombëtare e Auditimit.

Rezultatet sipas fazave të procesit buxhetor tregojnë dallime të theksuara në nivelin e pjesëmarrjes. Rezultati më i lartë është arritur në fazën e formulimit të buxhetit, me 73 pikë, që reflekton mekanizmat për dëgjime buxhetore me qytetarët në nivel të komunave. Këto mekanizma parashihen ligjërisht në kuadër të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike[8], si dhe Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur[9], të cilët obligojnë kuvendet komunale të mbajnë dëgjime buxhetore me qytetarë para se të miratohet buxheti dhe të dërgohet në Ministrinë e Financave. Komunat në shumë raste e publikojnë thirrjen për qytetarë në web-faqet e tyre apo llogaritë e rrjeteve sociale, ku informojnë ata për vendin dhe kohën e dëgjimeve të planifikuara, dhe në disa raste, pas mbajtjes së dëgjimeve, publikojnë raporte ku tregojnë se si janë trajtuar propozimet e qytetarëve. Në anën tjetër, në fazën e miratimit në Kuvend, mundësitë për pjesëmarrje të qytetarëve apo organizatave të shoqërisë civile kanë marrë zero pikë, meqë Qeveria apo Kuvendi nuk parashohin mekanizma për përfshirjen e tyre gjatë procesit të diskutimit të projekt-buxhetit dhe para miratimit të tij. Ngjashëm, edhe në fazën e zbatimit të buxhetit, gjatë hartimit dhe publikimit të raporteve financiare të buxhetit gjatë vitit, nuk parashihen mekanizma për përfshirje të publikut. Në anën tjetër, faza e auditimit është vlerësuar me 33 pikë, duke

[8] Gazeta Zyrtare. Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

[9] Gazeta Zyrtare. Udhëzim Administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna.

reflektuar disa mekanizma ekzistues jo-formalë të Zyrës Kombëtare të Auditimit për përfshirje të organizatave të shoqërisë civile në propozime të temave të reja për auditimit. Megjithatë, ky rezultat tregon se ende ka mundësi për përmirësim të përfshirjes së qytetarëve në këtë proces.

Figura 4. Shtrirja e mundësive për pjesëmarrjen e publikut në faza të ndryshme të procesit buxhetor



Burimi: Anketa e Buxhetit të Hapur (OBS), 2025.

Këto rezultate tregojnë se, megjithëse Kosova ka krijuar praktika të konsultimit publik gjatë hartimit të buxhetit në nivel lokal, pjesëmarrja e qytetarëve është e kufizuar dhe nuk është e shtrirë në mënyrë të barabartë përgjatë gjithë procesit buxhetor. Për këtë arsye, nevojitet që institucionet të ndërmarrin hapa konkretë për të zgjeruar mundësitë e përfshirjes së publikut edhe gjatë zbatimit dhe miratimit të buxhetit. Në veçanti, rekomandohet krijimi i mekanizmave që u mundësojnë qytetarëve të monitorojnë realizimin e shpenzimeve publike, si dhe zgjerimi i konsultimeve në nivel qendror, në mënyrë që të mos kufizohen vetëm në nivel lokal. Po ashtu, duhet t'u kushtohet më shumë vëmendje komuniteteve të nënpërfaqësuara, duke i përfshirë drejtpërdrejt ose përmes organizatave të shoqërisë civile që përfaqësojnë interesat e tyre.

Sa i përket rolit të Kuvendit në përfshirje të qytetarëve, rekomandohet që qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile t'u krijohet mundësia të paraqesin dëshmi dhe qëndrime gjatë dëgjimeve parlamentare për shqyrtimin e Propozim-Buxhetit, para miratimit të tij. E njëjta mundësi duhet të ofrohet edhe gjatë shqyrtimit të Raportit të Auditimit. Ndërkaq, Zyra Kombëtare e Auditimit, e cila tashmë ka vendosur mekanizma që mundësojnë kontributin e publikut në hartimin e programit të auditimit, duhet të zgjerojë këtë praktikë duke krijuar forma më të strukturuara për përfshirjen e qytetarëve në hetimet dhe proceset përkatëse të auditimit.

Në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë, Kosova është renditur si vendi me rezultatin më të lartë për pjesëmarrjen e publikut, me 32 pikë. Pas saj renditet Mali i Zi me 22 pikë, Shqipëria me 17 pikë, Maqedonia e Veriut me 9 pikë, Bosnja dhe Hercegovina me 7 pikë, Serbia me 2 pikë, ndërsa Turqia nuk ka shënuar pikë në këtë indikator. Mesatarja e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë është vetëm 13 pikë, që do të thotë se Kosova qëndron dukshëm mbi këtë mesatare.

Kjo renditje tregon se Kosova ka krijuar më shumë mundësi formale për përfshirjen e publikut në procesin buxhetor krahasuar me vendet e tjera të rajonit. Megjithatë, rezultati prej 32 pikëve mbetet i kufizuar dhe larg nivelit prej 61 pikëve, i cili konsiderohet si prag për pjesëmarrje të mjaftueshme. Për rrjedhojë, edhe pse Kosova ka performancën më të mirë rajonale, kjo nuk nënkupton se mekanizmat ekzistues janë të mjaftueshëm. Përmirësimi i pjesëmarrjes kërkon zgjerimin e konsultimeve publike në të gjitha fazat e ciklit buxhetor, veçanërisht gjatë miratimit dhe zbatimit të buxhetit, ku aktualisht nuk janë identifikuar mundësi formale të pjesëmarrjes.

4.3 Mbikëqyrja e buxhetit

Mbikëqyrja e buxhetit është komponenti i tretë i Anketës së Buxhetit të Hapur dhe vlerëson rolin e Kuvendit dhe institucioneve të auditimit si institucione mbikëqyrëse të procesit buxhetor. Ky komponent analizon në çfarë mase këto institucione mbikëqyrin propozimet buxhetore, zbatimin e buxhetit dhe analizojnë llogaritë përfundimtare të qeverisë. Sipas rezultateve të OBS 2025, Kosova ka arritur 61 pikë (nga 100) në mbikëqyrje të buxhetit, duke arritur pragun që konsiderohet si nivel i mjaftueshëm i mbikëqyrjes.

Figura 5. Pjesëmarrja e publikut në Kosovë krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë, 2025



Burimi: Anketa e Buxhetit të Hapur (OBS), 2025.

Nëse analizohen veçmas institucionet përgjegjëse për mbikëqyrje, vërehen dallime në performancën e tyre. Mbikëqyrja legjislative, e cila bëhet nga Kuvendi i Kosovës, është vlerësuar me 50 pikë, duke u klasifikuar si e kufizuar. Ndërkaq, mbikëqyrja e auditimit ka shënuar rezultat dukshëm më të lartë, me 84 pikë, që konsiderohet nivel i mjaftueshëm. Kjo tregon se Zyra Kombëtare e Auditimit ka një rol më të theksuar në mbikëqyrjen e financave publike, krahasuar me nivelin e kontrollit që ushtron Kuvendi gjatë fazave të ndryshme të procesit buxhetor.

Figura 6. Rezultatet e mbikëqyrjes legjislative dhe të auditimit në Kosovë, 2025



Burimi: Anketa e Buxhetit të Hapur (OBS), 2025.

Bazuar në rezultatet e mbikëqyrjes, rekomandohet që Kuvendi përmes komisioneve parlamentare të shqyrtojë më në detaje Propozimin e Buxhetit nga Qeveria dhe të publikojë një raport me gjetjet kryesore para votimit në seancë. Gjithashtu, komisionet parlamentare duhet të shqyrtojnë rregullisht raportet e realizimit të buxhetit dhe të publikojnë gjetjet dhe rekomandimet përmes një raporti. Një aspekt tjetër që kërkon përmirësim është përfshirja e Kuvendit në vendimet që lidhen me ndryshimet e paparashikuara buxhetore. Konkretisht, rekomandohet që Qeveria të konsultohet me komisionet parlamentare para se të shpenzojë të hyra të paplanifikuara ose të reduktojë shpenzimet si pasojë e mungesës së të hyrave të parashikuara. Po ashtu, komisionet parlamentare, pas shqyrtimit të Raportit Vjetor të Auditimit, duhet të publikojnë raporte me gjetjet dhe rekomandimet e tyre. Këto ndryshime do të kontribuonin në rritjen e llogaridhënies dhe në forcimin e mbikëqyrjes parlamentare në menaxhimin e financave publike.

Sa i përket mbikëqyrjes së auditimit, rezultati prej 84 pikëve tregon se ky komponent paraqet një nga pikat më të forta të sistemit të mbikëqyrjes buxhetore në Kosovë. Megjithatë, përmirësimet e mëtejshme duhet të fokusohen kryesisht në drejtim të përfshirjes së qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile në proceset e auditimit. Sipas rezultateve, rekomandohet që Zyra Kombëtare e Auditimit të krijojë mekanizma

formalë për t'u mundësuar qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile të kontribuojnë në hetimet dhe aktivitetet përkatëse të auditimit.

Në krahasim me vendet e rajonit dhe Turqinë, Kosova renditet në vendin e katërt, pas Malit të Zi, Shqipërisë dhe Turqisë. Mali i Zi ka rezultatin më të lartë me gjithsej 84 pikë, përcjellur nga Shqipëria me 69 pikë dhe Turqia me 65 pikë. Në anën tjetër, Maqedonia e Veriut dhe Serbia vlerësohen me 57 pikë, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina ka vlerësimin më të ulët, me gjithsej 48 pikë. Në përgjithësi, vendet si Mali i Zi dhe Shqipëria kishin performancë më të mirë në mbikëqyrjen legjislative apo nga Kuvendi krahasuar me Kosovën, që rezultoi edhe në vlerësim më të lartë në mbikëqyrje në përgjithësi.

Figura 7. Rezultatet e mbikëqyrjes në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi, 2025



Burimi: Anketa e Buxhetit të Hapur (OBS), 2025.

Një çështje tjetër e rëndësishme që evidenton OBS, ndonëse nuk vlerësohet me pikë, është mungesa e një institucioni të pavarur fiskal në Kosovë. Institucione të tilla kanë rol të rëndësishëm në ofrimin e analizave dhe vlerësimeve të pavarura për politikat fiskale, duke ndihmuar Qeverinë dhe Kuvendin në marrjen e vendimeve të informuara lidhur me buxhetin. Ato kontribuojnë gjithashtu në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, përmes monitorimit të politikave dhe zhvillimeve fiskale. Sipas raportit, Kosova ende nuk ka krijuar një institucion të tillë, ndërkohë që ekzistenca e tij do të mund të ndihmonte në përmirësimin e mbikëqyrjes së financave publike dhe në forcimin e debatit mbi politikat buxhetore.[10]

[10] Instituti GAP. Nevoja për themelimin e një Institucioni të Pavarur Fiskal në Kosovë Qershor 2024. Qasja e fundit më 15 nëntor 2026.

5. Përfundim dhe rekomandime

Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Hapur (OBS) 2025 tregojnë se Kosova ka shënuar progres të caktuar në transparencën dhe mbikëqyrjen e financave publike, si dhe në krijimin e mekanizmave për pjesëmarrjen e publikut në procesin buxhetor. Megjithatë, ky progres mbetet i pamjaftueshëm për të siguruar një proces buxhetor transparent, gjithëpërfshirës dhe të mbikëqyrur në mënyrë efektive. Me 57 pikë në transparencë, 32 pikë në pjesëmarrjen publike dhe 61 pikë në mbikëqyrje, rezultatet tregojnë se sfidat kryesore lidhen me cilësinë dhe gjithëpërfshirjen e dokumenteve buxhetore, mungesën e mekanizmave formal për pjesëmarrjen e qytetarëve gjatë të gjitha fazave të procesit buxhetor, si dhe rolin e kufizuar të Kuvendit në mbikëqyrjen parlamentare të financave publike.

Nga ana tjetër, rezultatet e larta të Zyrës Kombëtare të Auditimit tregojnë se auditimi i jashtëm përbën një nga shtyllat më të forta të mbikëqyrjes së financave publike në Kosovë. Megjithatë, nevojitet që edhe ky institucion të zgjerojë dhe formalizojë përfshirjen e qytetarëve dhe shoqërisë civile në proceset e auditimit. Po ashtu, mungesa e një institucioni të pavarur fiskal kufizon mundësitë për analiza dhe vlerësime të pavarura të politikave fiskale. Rrjedhimisht, përmirësimi i menaxhimit të financave publike në Kosovë kërkon angazhim të koordinuar të institucioneve përgjegjëse, me fokus në rritjen e transparencës, zgjerimin e pjesëmarrjes qytetare dhe forcimin e llogaridhënies institucionale përgjatë të gjitha fazave të ciklit buxhetor. Si përfundim, rezultatet e anketës tregojnë se performanca e Kosovës është e ngjashme me atë të vendeve të rajonit, dhe në një komponent si pjesëmarrja publike, edhe më e lartë.

Duke marrë parasysh rezultatet e kësaj ankete, Instituti GAP ofron disa rekomandime lidhur me disa nga dokumentet e analizuara, bazuar në institucionet përgjegjëse:

5.1 Ministria e Financave / Qeveria

1. **Të paraqiten shpenzimet buxhetore sipas klasifikimit funksional**, duke përfshirë në dokumentet buxhetore një tabelë të veçantë që grupon shpenzimet sipas funksioneve (arsim, shëndetësi, mbrojtje sociale, mjedis, etj.).
2. **Të dallohet qartë ndikimi fiskal i politikave ekzistuese dhe atyre të reja në Propozimin e Buxhetit**. Gjithashtu, të përmirësohet analiza e ndjeshmërisë makroekonomike, duke paraqitur se si ndryshimet në rritjen ekonomike, inflacion dhe norma të interesit mund të ndikojnë në të hyrat, shpenzimet, deficitin dhe borxhin publik.
3. **Të përfshihet në Propozimin e Buxhetit një pasqyrë e shpenzimeve tatimore**, e cila paraqet përjashtimet, normat e reduktuara, kreditë dhe lehtësimet tatimore, qëllimin e tyre, përfituesit dhe vlerësimin e të hyrave të humbura si rezultat i këtyre masave.
4. **Të publikohet me kohë Informatori për qytetarë (Buxheti i qytetarëve),** jo më vonë se fundi i muajit mars të vitit përkatës buxhetor, në mënyrë që qytetarët të kenë informatat e nevojshme në kohë.
5. **Të hartohet dhe publikohet Rishikimi i Mes-vitit çdo vit**, pavarësisht nëse nevojitet apo jo rishikim formal i buxhetit. Ky dokument duhet të përfshijë parashikime të përditësuara makroekonomike, vlerësime të rishikuara të të hyrave dhe shpenzimeve, projeksione të borxhit publik dhe shpjegime për devijimet kryesore nga buxheti i miratuar.
6. **Të përmirësohet raportimi gjatë zbatimit të buxhetit**, duke paraqitur shpenzimet sipas programeve, ndarjet fillestare, shpenzimet e realizuara dhe mjetet e mbetura. Po ashtu, të ofrohen arsyetime për devijimet e konsiderueshme nga ndarjet buxhetore, veçanërisht për investimet kapitale.

7. **Të përmirësohet përmbajtja e Raportit Vjetor Financiar**, duke përfshirë informata më të detajuara mbi realizimin dhe performancën e politikave publike, krahasimin ndërmjet rezultateve të planifikuara dhe atyre të arritura, ndikimin e shpenzimeve te grupet më të varfra dhe të cenueshme, si dhe të dhëna më të detajuara për borxhin publik dhe parashikimet makroekonomike.
8. **Të krijohet një mekanizëm konsultimi publik për buxhetin në nivel qendror**, përmes të cilit qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile do të mund të japin komente dhe propozime gjatë hartimit të buxhetit. Ky mekanizëm duhet të mundësojë gjithashtu informimin e publikut se si janë trajtuar propozimet e tyre.

5.2 Kuvendi i Kosovës

1. **Të fuqizohet roli i komisioneve parlamentare në shqyrtimin e Propozim-Buxhetit**, duke organizuar shqyrtime më të detajuara dhe duke publikuar raport me gjetjet dhe rekomandimet kryesore para votimit të buxhetit në seancë plenare.
2. **Të krijohen mundësi për pjesëmarrjen e qytetarëve apo organizatave të shoqërisë civile në shqyrtimin e Propozim-Buxhetit,** duke u mundësuar atyre të paraqesin dëshmi, komente dhe qëndrime gjatë dëgjimeve të organizuara nga komisionet parlamentare.
3. **Të sigurohet mbikëqyrje e rregullt e zbatimit të buxhetit**, përmes shqyrtimit të raporteve financiare tremujore, gjashtëmujore dhe nëntëmujore nga komisionet përkatëse, si dhe publikimit të raporteve me gjetjet dhe rekomandimet për institucionet përgjegjëse.
4. **Të forcohet mbikëqyrja parlamentare mbi ndryshimet e paparashikuara buxhetore**, duke siguruar që Qeveria të konsultohet me komisionet parlamentare para shpenzimit të të hyrave të paplanifikuara ose reduktimit të shpenzimeve për shkak të mungesës së të hyrave të parashikuara.
5. **Të sigurohet shqyrtimi i Raportit Vjetor të Auditimit nga komisionet parlamentare**, si dhe publikimi i raporteve që përmbajnë gjetjet kryesore, rekomandimet dhe kërkesat për adresimin e mangësive të identifikuara.
6. **Të krijohen mundësi për pjesëmarrjen e publikut në diskutimet parlamentare për buxhetin**, duke përfshirë konsultime dhe dëgjime publike jo vetëm gjatë shqyrtimit të buxhetit, por edhe gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të tij.

5.3 Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA)

1. **Të sigurohet informim dhe 'feedback' i qartë për kontributet e publikut gjatë hartimit të programit vjetor të auditimit**, duke bërë të ditur se si janë trajtuar propozimet e qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile, cilat prej tyre janë marrë parasysh dhe nëse kanë rezultuar në auditime, gjetje apo rekomandime të reja.
2. **Të krijohet një mekanizëm formal për qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile që të ofrojnë informacione gjatë auditimeve në proces**, dhe jo vetëm gjatë hartimit të programit vjetor të auditimit. Kjo mund të përfshijë kanale të sigurta për dorëzimin e dëshmive, informatave apo shqetësimeve që lidhen me një auditim në zhvillim.
3. **Të zgjerohen mundësitë për pjesëmarrjen e publikut në proceset e auditimit**, duke përfshirë konsultimin me qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile për çështjet që lidhen me përdorimin e fondeve publike dhe identifikimin e fushave që kërkojnë vëmendje të veçantë audituese.
4. **Të përmirësohet komunikimi me publikun lidhur me rezultatet e auditimeve**, përmes publikimit të informatave të kuptueshme dhe lehtësisht të qasshme mbi gjetjet kryesore, rekomandimet dhe rëndësinë e tyre për menaxhimin e financave publike.

Aneks 1 – Metodologjia

Shumica e pyetjeve të pyetësorit të Anketës së Buxhetit të Hapur kanë pesë opsione për përgjigje, duke filluar nga "a" që nënkupton se standardi është përmbushur plotësisht apo është tejkaluar, deri te "d" që tregon se standardi nuk është përmbushur fare, ose "e" që tregon se nuk është e aplikueshme. Gjithashtu, disa pyetje kanë tre opsione për përgjigje: "a" (standardi është përmbushur), "b" (standardi nuk është përmbushur) dhe "c" (nuk është e aplikueshme). Për të llogaritur rezultatet përfundimtare, përgjigjet kthehen në pikëzim numerik nga 0 deri në 100.[11]

Tabela 1. Pesë opsionet për përgjigjet e pyetësorit dhe pikëzimet numerike

Lloji i përgjigjes	Përshkrimi i përgjigjes	Pikëzimi numerik
"a"	Standardi është përmbushur plotësisht ose është tejkaluar	100
"b"	Standardi është përmbushur kryesisht	67
"c"	Përpjekje minimale për të përmbushur standardin	33
"d"	Standardi nuk është përmbushur	0
"e"	Nuk është e aplikueshme	-

Përgjigjet në pyetësor mbështeten nga burime që ofrojnë dëshmi për secilën përgjigje. Këto burime mund të jenë dokumente buxhetore ose që i bashkëngjiten buxhetit, ligje, ose intervista me zyrtarë qeveritarë, deputetë apo ekspertë të fushës. Procesi i hulumtimit u zhvillua sipas udhëzimeve për përgjigje në pyetjet e anketës, dhe së pari, përgjigjet u rishikuan nga stafi i IBP-së dhe më pas nga një rishikues i pavarur. Për dallim nga OBS 2023, përgjigjet ndonëse u dërguan për komente në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, ato nuk u rishikuan nga ky institucion.

Për pjesën e transparencës buxhetore në këtë anketë, u vlerësuan tetë dokumente buxhetore. Afati i fundit për publikimin e dokumenteve/ngjarjeve të vlerësuara ishte 31 dhjetor 2024. Këto dokumente lidhen me dy faza të procesit buxhetor: fazën e planifikimit dhe fazën e ekzekutimit.

Vlerësimi i pyetjeve u llogarit si mesatare e thjeshtë e pikëve për secilin dokument buxhetor. Megjithatë, pasi numri i pyetjeve për "Propozimin e Buxhetit nga Ekzekutivi" ishte shumë më i madh në krahasim me dokumentet e tjera, ai mori më shumë peshë dhe u konsiderua dokumenti më i rëndësishëm buxhetor.

[11] International Budget Partnership. Lidhur me Anketën e Buxhetit të Hapur. Qasur së fundmi më: 12 nëntor 2026

Tabela 2. Tetë dokumentet buxhetore të shqyrtuara dhe të vlerësuara për OBS 2025 në Kosovë

Emri i dokumentit sipas metodologjisë OBS	Emri i dokumentit ekuivalent në Kosovë	Numri i pyetjes në OBS
FAZA E PLANIFIKIMIT		
Deklarata e Para-Buxhetit	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2025-2027	**54-58**
Propozimi i Buxhetit nga Ekzekutivi *(përfshirë dokumentet mbështetëse)*	Projektligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025	**1-53**
Buxheti i miratuar	Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025	**59-63**
Buxheti i Qytetarëve	Broshurë informative për qytetarët 2024	**64-67**
FAZA E EKZEKUTIMIT		
Raportet gjatë-vitit	- Raporti Financiar tremujor për Buxhetin e Republikës së Kosovës (janar-mars 2024) - Raporti Financiar gjashtëmujor për Buxhetin e Republikës së Kosovës (janar-qershor 2024) - Raporti Financiar nëntëmujor për Buxhetin e Republikës së Kosovës (janar-shtator 2024)	**68-75**
Rishikimi i mes-vitit	N/A[12]	**76-83**
Raporti i fundvitit	Raporti Financiar Vjetor për Buxhetin e Republikës së Kosovës 2023	**84-96**
Raporti i Auditimit	Raporti i Auditimit për Buxhetin e Republikës së Kosovës 2023	**97-102**

[12] Rishikimi i Mes-Vitit në Kosovë nuk u vlerësua pasi nuk kishte një dokument të tillë të publikuar.

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE

Instituti GAP është think-tank i themeluar në vitin 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mes qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

www.institutigap.org

Rr. Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr.4,
10000 Prishtinë

+383 38 609 339

info@institutigap.org

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE